

**RELACION SHPJEGUES  
PËR PROJEKTVENDIMIN  
“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË  
SHËRBIMEVE POSTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR  
VITET 2021 – 2026”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi “*Për miratimin e dokumentit të politikës së shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë për vitet 2021 – 2026*” vjen si propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, bazuar në nenin 6, të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Dokumenti synon prezantimin e politikës së re të zhvillimit të sektorit postar në Republikën e Shqipërisë, për periudhën 2021-2026, me qëllim përcaktimin e objektivave për përshtatjen e këtij sektori me zhvillimet më të fundit të sektorit postar në Bashkimin Evropian dhe atë global, përmirësimin e performancës si dhe adoptimin e zhvillimeve të reja në kuadër të tregtisë elektronike (e-commerce).

Projektakti ka për qëllim të miratojë dokumentin e ri, i cili zëvendëson dokumentin e mëparshëm të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 24.7.2013 “Për miratimin e dokumentit të zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcaktoi si objektiv të rëndësishëm hapjen e plotë të tregut postar për konkurrencë duke reduktuar dhe më pas hequr zonën e rezervuar për ofrimin e shërbimit universal postar.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projekt akti është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2020, në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian në kapitullin 3: “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime” dhe vjen si nevojë e përditësimit të objektivave afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillimin e sektorit postar në Shqipëri me synim reflektimin e zhvillimeve të ndodhura në treg, si ato teknologjike dhe zhvillimet globale, duke i përshtatur ato me tregun shqiptar.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6 parashikon hartimin nga ana e ministrit përgjegjës për shërbimet postare të politikave të zhvillimit të sektorit postar në Republikën e Shqipërisë. Hartimi i këtij dokumenti del i nevojshëm në kuadër të përfundimit të periudhës së parashikuar në dokumentin e mëparshëm të politikave, si dhe në kuadër të rinovimit të Autorizimit Individual “Për ofrimin e Shërbimit Universal në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projekt akti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës si dhe nenit 6, të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projekt akti nuk bën përafrim të ndonjë *acquis* specifike të BE-së.

### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Dokumenti i politikës së shërbimeve postare që miratohet me këtë projekt akt është i organizuar në 6 kapituj dhe përmban dy Aneksë.

**Në kapitullin 1 “Analizë e situatës aktuale”** i cili është ndarë në 3 nënkapituj, jepet një pasqyrë e situatës së përgjithshme aktuale të sektorit postar në Republikën e Shqipërisë. Nënkapitulli 1 “Të përgjithshme-kuadri ligjor dhe institucional në sektorin postar” bën një përshkrim të tregut postar në Shqipëri pas miratimit të dokumentit të mëparshëm të politikave, dokument ky që përcaktonte si objektiv kryesor përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë *acquis communautaire* të BE-së me synim hapjen graduale dhe të kontrolluar deri në liberalizim të plotë, të tregut postar. Gjithashtu, në të përshkruhet legjislacioni aktual në fuqi, i cili bën rregullimin e sektorit postar në Shqipëri, si organet kompetente në fushën e shërbimeve postare. Nënkapitulli 2 “Zhvillimet kryesore në tregun postar” përshkruan dhe analizon situatën aktuale të ofrimit të shërbimeve postare në Shqipëri, zhvillimet kryesore në tregun postar, duke

---

*Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e dokumentit të politikës së shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë për vitet 2021 – 2026”*

dhënë një pasqyrë të treguesve të ndryshëm, si numrin e objekteve postare të pranuara, numrin e zyrave postare në vend, numrin e të punësuarve, zhvillimet në infrastrukturë etj. Nënkapitulli 3 “Ofrimi i shërbimeve nga Posta Shqiptare sh.a.” përshkruan shërbimet bazë postare të ofruara nga Posta Shqiptare, duke theksuar faktin se zhvillimi dhe përmirësimi i shërbimeve të ofruara është ndikuar në një masë të madhe nga informatizimi i shërbimeve, përdorimi i TIK duke sjellë rritje të performancës dhe të cilësisë, rritje të shumëllojshmërisë së shërbimeve tradicionale dhe atyre financiare dhe shtrirjen e tyre në të gjithë territorin e vendit.

**Në kapitullin 2 “Statusi i Shërbimit Universal Postar”,** i cili është i ndarë në 2 nënkapituj dhe 1 seksion jepet një pasqyrë e situatës së shërbimit universal, i cili është një ndër objektivat kryesorë të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”. Në të përshkruhen kërkesat që duhet të zbatohet ofruesi i shërbimit universal, në këtë rast Posta Shqiptare sh.a., në bazë të Autorizimit Individual, si dhe jepet një panoramë e volumit të shërbimit universal, brenda dhe jashtë vendit, ndër vite. Në nënkapitullin 1 “Standardet e cilësisë së ofrimit të shërbimit universal” paraqiten rezultatet e testeve të realizuara nga Posta Shqiptare sh.a. në lidhje me standardet mbi kohën e shpërndarjes së objekteve postare të shërbimit universal. Në seksionin “Tarifat e ofrimit të shërbimeve universale postare” bëhet një analizë e regjimit të tarifave të shërbimeve bazë në Shqipëri dhe në vendet e Bashkimit Evropian. Theksohet se, megjithëse tarifat në Shqipëri nuk kanë ndryshuar për një periudhë të gjatë kohore, çmimet ende janë të larta në krahasim me të ardhurat lokale dhe se njëkohësisht është i nevojshëm rishikimi i tyre. Në nënkapitullin 2 “Probleme të Shërbimit Universal postar në Shqipëri” përshkruhen problematikat e evidentuara nga Posta Shqiptare përsa i përket shpërndarjes dhe dorëzimit të objekteve postare, duke theksuar se problemi kryesor qëndron në sistemin e pasaktë të adresave në Shqipëri. Ky problem është një faktor përkeqësues për cilësinë e ofrimit të shërbimeve postare në tërësi dhe shërbimit universal në veçanti.

**Në kapitullin 3 “Tendencat globale dhe evropiane – sfidat në zhvillimin e tregut postar”,** i cili është i ndarë në 3 seksione paraqiten sfidat me të cilat po përballet tregu postar si rrjedhojë e reduktimit të volumit të postës së letrave dhe rritjes së shpejtë të dërgesave të pakove, duke sjellë sfida në ofrimin e ofrimin e shërbimit universal. Në seksionin “Shërbimi postar dhe tregtia elektronike”, jepet një përshkrim i analizë të kryer nga ekspertët e Bankës Botërore për situatën e tregtisë elektronike në Shqipëri dhe mundësitë që kjo ofron për rritjen ekonomike të vendit. Analiza prek çështje të tilla si infrastruktura postare, sistemi i adresave, procedurat doganore për tregtinë elektronike, kostot e shërbimit postar ndërkombëtar, etj. Seksioni “Ndikimi i COVID-19 në

shërbimin postar” jep një pasqyrë të situatës në të cilën u ndodh i tërë globi gjatë vitit 2020, të ndikimit që pati edhe në shërbimin postar, si dhe të masave të ndërmarra nga Shqipëria për të përballuar këtë ndalim të punës normale të shërbimit postar. Seksioni “Sfidat e zhvillimit në tregun postar” liston sfidat kryesore që kanë ardhur si rrjedhojë e zhvillimeve në tregun postar, të tilla si reduktimi i postës së letrave dhe rritja e volumeve të pakove postare, si dhe parashtron dhe disa problematika si vështirësia në ruajtjen e konkurrencës së ndershme, rritja e kostos për ofrimin e shërbimeve në zonat rurale etj.

**Në kapitullin 3 “Vizioni dhe objektivat e sektorit postar”** përcaktohet vizioni për zhvillimin e sektorit postar në periudhën afatmeshme dhe afatgjatë. Këtu theksohen objektivat e zhvillimit të sektorit postar që kanë të bëjnë me zhvillimin e infrastrukturës së rrjetit postar, zbatimin e standardeve ndërkombëtare, garantimin e zhvillimit të shërbimeve universale cilësore, mbështetjen në implementimin e teknologjisë bashkëkohore të inovacionit, etj.

**Në kapitullin 4 “Masat që do ndërmerren”,** i cili është i ndarë në disa seksione, jep një kuadër të masave dhe të projekteve që do të implementohen, të cilat do të bëjnë të mundur që sektori postar ti pëshatet në mënyrë sa më të mirë ndryshimeve teknologjike dhe modeleve të reja të konsumit, duke u bërë kështu një komponent thelbësor i ekonomisë digjitale. Masat që do të ndërmerren kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e shërbimeve, rishikimin e tarifave dhe tregun digjital. Seksioni “Bashkëpunimi ndërkombëtar” paraqiten objektivat e Strategjisë Globale Postare, të ndara në katër fusha kryesore veprimi. Seksioni “Projekte në bashkëpunim me UPU” listohen projektet e të cilat Posta Shqiptare sh.a. do të realizojë me mbështetjen e UPU-së. Ndërsa seksioni “Bashkëpunimi i mëtejshëm me UPU” parashtron aspektet kryesore në të cilat synohet një bashkëpunim më i ngushtë dhe të cilat kërkojnë vëmendje si bashkëpunimi me administratën doganore, përfshirja financiare dhe përgjigja ndaj fatkeqësive.

**Në kapitullin 5 “Monitorimi dhe zbatimi i politikës postare”** paraqiten indikatorët e performancës për shërbimet universale, të cilat do të monitorohen periodikisht , si dhe përshkruhen angazhimet e secilit institucion për monitorimin e këtij dokumenti politikash në përputhje me parashikimet ligjore.

Dokumenti i Politikës Postare shoqërohet dhe me dy anekse.

**Aneksi 1** jep një përmbledhje të gjithë akteve nënligjore, të miratuara në periudhën 2016-2018, në zbatim të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

**Aneksi 2** jep disa nga projektet e parashikuar nga Posta Shqiptare sh.a. për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimeve.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projekt akti janë Ministri për Infrastrukturën dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektakti është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit. Aktivitetet e parashikuara në aspektet ligjore e rregullatore përbëjnë kosto administrative dhe do mbulohen nga buxhetet respektive të Ministrisë dhe AKEP. Për projektet e parashikuara për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve postare universale për implementim nga Posta Shqiptare sh.a. do mbulohen nga vetë shoqëria.